Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA E KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr/Br. 923/20
Datë/Datum. 03.12.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.923/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Goran Milenković - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatoret ekonomik "STUDIO HAPSIRA" SH.P.K. & "TAULANT"SH.P.K & "AVE CONSULTING"SH.P.K– Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë Grupi i operatorëve ekonomik: "I.E.C - BIO"; N.N.SH. EGO-ELSA; ASTREKS DOOEL- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbimi i projektimit të rezervuarit të ri të mazutit 2000 m3", me nr. të prokurimit: KEK-20-56-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosovës sh.a, më datën: 02.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorëve ekonomik "STUDIO HAPSIRA" SH.P.K. & "TAULANT"SH.P.K & "AVE CONSULTING"SH.P.K– Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbimi i projektimit të rezervuarit të ri të mazutit 2000 m3", me nr. të prokurimit: KEK-20-56-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosovës sh.a.

II. **ANULOHET**, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbimi i projektimit të rezervuarit të ri të mazutit 2000 m3", me nr. të prokurimit: KEK-20-56-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosovës sh.a , dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "STUDIO HAPSIRA" SH.P.K. & "TAULANT"SH.P.K & "AVE CONSULTING"SH.P.K– Prishtinë, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatorët ekonomik ankues "STUDIO HAPSIRA" SH.P.K. & "TAULANT"SH.P.K & "AVE CONSULTING"SH.P.K– Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 12.11.2020 me nr. 923/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbimi i projektimit të rezervuarit të ri të mazutit 2000 m3", me nr. të prokurimit: KEK-20-56-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosovës sh.a, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 13, 56, 59, 69 dhe 71 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 13.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 23.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Pretendimi nr. 1

Eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja, pas vlerësimit te ofertave ka rekomanduar për kontrate OE "I.E.C – Bio&Astreks&Ego Elsa", si ofertë te përgjegjshme me çmim me te ulet, ndërsa OE ankues ne ankesën e tij ka pretendime ankimore lidhur me ofertën e te rekomanduarit për kontrate, duke pretenduar se i njëjti nuk i plotëson te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues, pretendon se anëtarëve te konzorciumit "Astrex" – Maqedoni dhe "Ego Elsa" – Prishtine, ju mungon certifikata e TVSH-se.

Fillimisht lidhur me ketë pretendim eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja, ne dosje te tenderit e ka kërkuar certifikatën e TVSH-se.

Pas ekzaminimit te ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, eksperti shqyrtues sqaron se të dy operatorët

ekonomik të lartpërmendur nuk i kanë dorëzuar certifikatat e TVSH-së. Megjithatë eksperti shqyrtues, vlerëson se nuk mund të eliminohet një operator ekonomik lidhur me mungesën e certifikatëse së TVSH-së, për faktin se kjo rregullohet me legjislacion dhe për të njëjtën certifikatë operatori ekonomik duhet ti përmbush kriteret që të pajiset me certifikatën e TVSH-së, që do të thotë se jo domosdoshmërisht një operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatën e TVSH-së.
Lidhur me këtë pretendim eksperti shqyrtues, vlerëson se AK-ja, është dashur të bëjë një vlerësim më të detajuar të këtij pretendimi të OE ankues, duke e sqaruar konform nenit 72 dhe 59 të LPP-së, për faktin se njëri nga operatorët ekonomik është nga Maqedonia dhe të njëjtin e kanë të rregulluar me ligj çështjen e TVSH-së dhe pas sqarimit me operatorët ekonomik dhe institucionet përgjegjëse të cilat e lëshojnë ketë certifikate, të veproj në harmoni me nenin 39 të Rregullores dhe Udhëzuesit operativ për prokurim publik, konkretisht pikës pesë (5) në tabelën e dhënë të këtij neni. Prandaj, eksperti shqyrtues vlerëson se ky pretendim i OE ankues është pjesërisht i qëndrueshëm përderisa të vërtetohet sipas sqarimit të dhënë më lartë.

Sa i përket pretendimit të OE ankues, se i rekomanduari për kontratë nuk e ka plotësuar kërkesën e DT-së, lidhur me referencat e ngjashme ku AK-ja, i ka kërkuar se paku 2 referenca, konkretisht pretendon se referenca e lëshuar për OE Petroll Olti Sllovenia&Astrex, nuk e përmbush kërkesën e AK-së, me arsyetimin se në referencë thuhet se ka projektuar objekte arkitektonike dhe infrastrukturore me sipërfaqe 40000m2.
Eksperti shqyrtues duke u bazuar në kërkesën e dosjes së tenderit ku AK-ja, ka kërkuar: Projekte të ngjashëm të realizuar ne tre vitet e fundit, vlerëson se i rekomanduari për kontrate e ka plotësuar kërkesën e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate, për faktin se AK-ja, ne dosje te tenderit ka kërkuar projekte te ngjashme. Prandaj, ky pretendim nuk qëndron.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se i grupi i OE-ve të cilët janë rekomanduar për kontratë, nuk e plotësojnë kërkesën lidhur me projekt menaxherin, me arsyetimin se projekt menaxher është caktuar Faton Gashi dhe i njëjti nuk figuron as në listën e stafit, të njëjtit sipas OE ankues i mungon edhe diploma, CV, referenca sipas kërkesës. Për te njëjtin pretendim OE ankues, e bazon ne një deklarate ku anëtarët e konzorciumit kanë deklaruar se e caktojnë Faton Gashin si menaxher të projektit.
Eksperti shqyrtues sqaron se konzorciumi i rekomanduar për kontratë, në një nga deklaratat e parapara sipas nenit 71 të LPP-së, kanë deklaruar se Faton Gashi është i autorizuar që të përfaqësoj grupin dhe njëherit caktohet edhe si menaxher i projektit.
Eksperti shqyrtues, sqaron po ashtu se lidhur me kërkesën e AK-se, për caktim te menaxherit te projektit përmes vendimit, ka gjetur se ne ofertën e te rekomanduarit për kontrate, konkretisht ne listën e stafit znj. Metodija Tomeski përmendet si menaxhere e projektit.

Duke u bazuar ne sqarimin e dhënë me lart, eksperti shqyrtues vlerëson se ka paqartësi rreth caktimit te menaxherit të projektit për faktin se AK-ja, në vendimin e kërkesës për rishqyrtim ka deklaruar se menaxher i projektit është znj. Metodija Tomeski dhe nuk është Faton Gashi. Megjithatë eksperti shqyrtues duke u bazuar ne kërkesën e dosjes se tenderit vlerëson se ka mjaftueshëm dëshmi se znj. Metodija Tomeski është menaxhere e projektit dhe njeherit vlerëson se ky pretendim nuk qëndron sepse kërkesë ne dosje te tenderit ka qene qe: Operatori ekonomik duhet te përcaktoj Menaxherin e Projektit, pra nuk është kërkuar vendim dhe e njëjta siç u sqarua me larte ne listën e stafit profesional është caktuar menaxhere e projektit.

Sa i përket pretendimit të OE ankues lidhur me deklaratat e themelimit të konzorciumit të parapara në nenin 71 të LPP-së, ku pretendon se njëri nga anëtarët e konzorciumit nuk e ka nënshkruar njërën nga deklaratat, eksperti shqyrtues vlerëson se ky pretendim qëndron për faktin se anëtari i konzociumit Ego Elsa, nuk e ka nënshkruar deklaratën për autorizim te kontraktimit.

Sa i përket pretendimit të OE ankues, se OE i rekomanduar për kontratë lidhur me stafin profesional (Inxhinieret: Metodija Tomeski, Stamat Samduloski, Stojan Petrovski, Zvonimir Todorovski), ka ofruar certifikata dhe nuk ka ofruar diploma sipas kërkesës, eksperti shqyrtues, sqaron se qëndron pretendimi i OE ankues, për faktin se i rekomanduari për kontrate nuk ka ofruar diploma por certifikata të cilat pasi që janë të lëshuara nga shteti i Maqedonisë eksperti shqyrtues, nuk mund të konstatoj ekuivalencën e këtij dokumenti me diplomën, prandaj, eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja, duhet ti vërtetoj certifikatat e dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontrate.

Lidhur me të njëjtën kërkesë, ku AK-ja për secilin inxhinier ka kërkuar, citat: Një inxhinier i diplomuar apo master.... OE ankues pretendon se inxhinieret e lartpërmendur janë bachelor dhe nuk janë master apo të diplomuar, nuk qëndron për faktin se AK-ja ka kërkuar inxhinier të diplomuar apo master, që do të thotë se nuk e ka përcaktuar gradën, por ka kërkuar që të jetë i diplomuar në fushën përkatëse, prandaj ky pretendim nuk qëndron.

Sa i përket pretendimit te OE ankues, se i rekomanduari për kontrate, ka ofruar Cv-it e stafit profesional (Stamat Samduloski, Stojan Petrovski,), te cilat janë ne kundërshtim me nenin 13 te LPP-se, me arsyetimin se i ka ofruar ne gjuhen Maqedone, qëndron dhe për te njëjtat eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja është dashur te veproj ne harmoni te plot me pyetje/përgjigjen nr. 66 te publikuar ne ëeb faqen e KRPP-se.
Po ashtu është i qëndrushem pretendimi i OE ankues se i rekomanduari për kontratë nuk ka dorëzuar CV për Zvonimir Todorovski si pjesë e stafit profesional, andaj eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja duhet të veproj në përputhje me nenin 39 të RrUOPP-se, pikës 11 të tabelës së dhëne në ketë rregullore.

Duke u bazuar ne sqarimet e dhëna me lart, eksperti shqyrtues, ka vërejtur se AK-ja, nuk e ka bere vlerësimin e ofertave sipas nenit 59 te LPP-se, për arsyet qe u ceken me larte, andaj eksperti shqyrtues, vlerëson se AK-ja, duhet te qe gjate rivlerësimit te shpalle te përgjegjshëm vetme ofertën e cila është ne përputhje te plot me kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues te aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa vendimi i AK-së për dhënie te kontratës te anulohet dhe lënda te kthehet ne Rivlerësim.
Autoriteti Kontraktues, me datë: 26.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se Nuk Pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti kontraktues / komisioni i vlerësimit NUK PAJTOHET me raportin e ekspertit shqyrtues te ankese nr. 923/20. Komisioni ka bere vlerësimin ne pajtueshmëri me kërkesat ne Dosjen e tenderit dhe Njoftim për kontratë Ne vijim përgjigjet e komisionit te rivlerësimet ne raporti e ekspertit shqyrtues te OSHP-se
Komisioni I rivlerësimit për tenderin "Shërbimi i projektimit te rezervuarit te ri te mazutit 2000 m³ " ne TC "KOSOVA B"-KEKC-20-008-221. Nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues nr.923/20 te dt.23.11.2022 ne këto pika .

1. Sa I përket mungesës se certifikatës te TVSH për EGO ELSA Prishtinë dhe "Astrex" Maqedoni edhe eksperti shqyrtues ka vlerësuar se nuk mund te eliminohet OE. Çka mund te kërkohet nga OE qe te plotësohet ky kusht .
2. Pretendimi se njeri nga anëtaret e kozorciumit nuk e ka nënshkruar njërën nga deklaratat komisioni nuk pajtohet me këtë pretendim qe e ka dhënë Eksperti shqyrtues . Sepse anëtaret e konzorciumit te OE "I.E.C- BIO L.L.C & "EGO-ELSA & "ASTREX " Maqedoni kanë kontrate (Marrëveshje) për formimin e grupit te OE dhe kanë caktuar Lider te kësaj Kontrae "I.E.C BIO L.L.C . ku janë Autorizimet e e çdonjërit te vulosura qe e autorizojnë liderin për këtë kontratë. Kështu qe edhe EGO-ELSA e ka autorizim qe e ka vulosur dhe nënshkruar për liderin e konzorciumit .
3. Sa I perkete pretendimit se OE ankues se i rekomanduar për kontrate ka afruar CV ne gjuhen Maqedone , për komisionin e rivlerësimit këto CV kanë qene te kuptueshme dhe janë alfabetin latin çka komisioni nuk ka pas problem te deshifroi dhe kuptoi dhe kjo nuk qëndron sipas komisionit te rivlerësimit.
4. Sa I përket pretendimit se OE nuk ka dorëzuar CV për Zvonimir Todoirovski komisioni I rivlerësimit mendon qe ky pretendim nuk qëndron , sepse OE I cili është rekomanduar për kontratë ka staf te mjaftueshëm qe te inxhiniereve te diplomuar qe e plotësojnë këtë kriter dhe atë po I cekim si ne vijim .

- Vllado Jashmak, Inxh.i diplomuar I teknologjisë per mbrojtje te ambientit
- Metodija Tomeski , inxh I diplomuar I ndërtimtarisë – menaxher i projektit .
- Stomat sandullovski inxh I diplomuar I elektroteknikes .
- Mirlind Bruqi ,Dr i makinerisë .
- Llazo Sandullovski , inxh, dip . e elektroteknikes .

Te gjithe këta eksperte kane përvoje mbi 15 vjeçare dhe janë te licencuar për projekte te tilla nga organet kompetente te lëshojnë certifikatat qe këta kanë te drejte te bëjnë projekte ne fushën sipas kualifikimeve përkatëse.

Kështu qe edhe ky pretendim nuk qëndron sipas komisionit te rivlerësimit.

Operatori Ekonomik, me datë: 27.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se Pajtohet Pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Përshëndetje pajtohemi pjesërisht me mendimin e ekspertit.

Nuk pajtohemi te pika e caktimit te menaxherit te projektit pasi qe edhe vete eksperti ka deklaruar se ka paqartësi te caktimit te menaxherit nga OE e propozuar për kontratë dhe se sipas rregullave te LPP duhet qe gjate përpilimit dhe dorëzimit te FDT duhet te jete ne harmoni dhe te mos ketë paqartësi.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 02.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e grupit të operatorëve ekonomik ankues "STUDIO HAPSIRA" SH.P.K. & "TAULANT"SH.P.K & "AVE CONSULTING"SH.P.K– Prishtinë, se anëtarëve te konzorciumit të rekomanduar "Astrex" – Maqedoni dhe "Ego Elsa" – Prishtine, ju mungon certifikata e TVSH-së.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK në dosje të tendrit ka kërkuar certifikatën e TVSH-së. Ndërsa, të anëtarët e konsorciumit të lartcekur nuk i kanë dorëzuar certifikatat e TVSH-së. Megjithatë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se nuk mund të eliminohet një operator ekonomik lidhur me mungesën e certifikatëse së TVSH-së, për faktin se kjo rregullohet me legjislacion dhe për të njëjtën certifikatë operatori ekonomik duhet ti përmbush kriteret që të pajiset me certifikatën e TVSH-së, që do të thotë se jo domosdoshmërisht një operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatën e TVSH-së.

Lidhur me këtë pretendim, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se AK është dashur të bëjë një vlerësim më të detajuar të këtij pretendimi të OE ankues, duke e sqaruar konform nenit 72 dhe 59 të LPP-së, për faktin se njëri nga operatorët ekonomik është nga Maqedonia dhe të njëjtin e kanë të rregulluar me ligj çështjen e TVSH-së dhe pas sqarimit me operatorët ekonomik dhe institucionet përgjegjëse të cilat e lëshojnë ketë certifikate, të veproj në harmoni me nenin 39 të Rregullores dhe Udhëzuesit operativ për prokurim publik, konkretisht pikës pesë (5) në tabelën e dhënë të këtij neni. Prandaj, ky pretendim i OE ankues është pjesërisht i qëndrueshëm përderisa të vërtetohet sipas sqarimit të dhënë më lartë.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues, se i rekomanduari për kontratë nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit lidhur me referencat e ngjashme, ku AK i ka kërkuar se paku 2 referenca, konkretisht pretendon se referenca e lëshuar për OE Petroll Olti Sllovenia&Astrex, nuk e përmbush kërkesën e AK-së, me arsyetimin se në referencë thuhet se ka projektuar objekte arkitektonike dhe infrastrukturore me sipërfaqe 40000m2.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se duke u bazuar në kërkesën e dosjes së tenderit, ku AK ka kërkua projekte të ngjashëm të realizuar ne tre vitet e fundit. Ndërsa, OE i rekomanduar për kontrate e ka plotësuar kërkesën e dosjes se tenderit dhe të njoftimit për kontratë për faktin se AK në dosje të tenderit ka kërkuar projekte të ngjashme. Prandaj, ky pretendim nuk qëndron.

Lidhur me pretendimin e radhës të OE ankues, se i grupi i OE-ve të cilët janë rekomanduar për kontratë, nuk e plotësojnë kërkesën lidhur me projekt menaxherin, me arsyetimin se projekt menaxher është caktuar Faton Gashi dhe i njëjti nuk figuron as në listën e stafit, të njëjtit sipas OE ankues i mungon edhe diploma, CV, referenca sipas kërkesës. Për te njëjtin pretendim OE ankues, e bazon ne një deklarate ku anëtarët e konzorciumit kanë deklaruar se e caktojnë Faton Gashin si menaxher të projektit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se konzorciumi i rekomanduar për kontratë, në një nga deklaratat e parapara sipas nenit 71 të LPP-së, kanë deklaruar se Faton Gashi është i autorizuar që të përfaqësoj grupin dhe njëherit caktohet edhe si menaxher i projekti. Për më tepër, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se lidhur me kërkesën e AK-së për caktim të menaxherit të projektit përmes vendimit, ka gjetur se në ofertën e të rekomanduarit për kontratë, konkretisht në listën e stafit znj. Metodija Tomeski përmendet si menaxhere e projektit. Duke u bazuar në sqarimin e dhënë më lart, shihet se ka paqartësi rreth caktimit të menaxherit të projektit për faktin se AK në vendimin e kërkesës për rishqyrtim ka deklaruar se menaxher i projektit është znj. Metodija Tomeski dhe nuk është Faton Gashi. Megjithatë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues duke u bazuar ne kërkesën e dosjes se tenderit vlerëson se ka mjaftueshëm dëshmi se znj. Metodija Tomeski është menaxhere e projektit dhe njëherit vlerëson se ky pretendim nuk qëndron sepse kërkesë në dosje të tenderit ka qenë që: Operatori ekonomik duhet te përcaktoj

Menaxherin e Projektit, pra nuk është kërkuar vendim dhe e njëjta siç u sqarua më lartë në listën e stafit profesional është caktuar menaxhere e projektit.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues lidhur me deklaratat e themelimit të konzorciumit të parapara në nenin 71 të LPP-së, ku pretendon se njëri nga anëtarët e konzorciumit nuk e ka nënshkruar njërën nga deklaratat, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se ky pretendim qëndron për faktin se anëtari i konzociumit Ego Elsa, nuk e ka nënshkruar deklaratën për autorizim te kontraktimit.

Sa i përket pretendimit të OE ankues, se OE i rekomanduar për kontratë lidhur me stafin profesional (Inxhinieret: Metodija Tomeski, Stamat Samduloski, Stojan Petrovski, Zvonimir Todorovski), ka ofruar certifikata dhe nuk ka ofruar diploma sipas kërkesës.
Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues, sqaron se qëndron pretendimi i OE ankues për faktin se i rekomanduari për kontratë nuk ka ofruar diploma por certifikata të cilat pasi që janë të lëshuara nga shteti i Maqedonisë nuk mund të vihet deri te konstatimi për barasvlerën e këtij dokumenti me diplomën. Prandaj, Paneli Shqyrtues konform eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja, duhet ti vërtetoj certifikatat e dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë.

Lidhur me të njëjtën kërkesë, ku AK-ja për secilin inxhinier ka kërkuar, citat: Një inxhinier i diplomuar apo master.... OE ankues pretendon se inxhinieret e lartpërmendur janë bachelor dhe nuk janë master apo të diplomuar, nuk qëndron për faktin se AK-ja ka kërkuar inxhinier të diplomuar apo master, që do të thotë se nuk e ka përcaktuar gradën, por ka kërkuar që të jetë i diplomuar në fushën përkatëse, prandaj ky pretendim nuk qëndron.

Sa i përket pretendimit te OE ankues, se i rekomanduari për kontratë ka ofruar Cv-it e stafit profesional (Stamat Samduloski, Stojan Petrovski,), të cilat janë në kundërshtim me nenin 13 të LPP-së, me arsyetimin se i ka ofruar në gjuhen Maqedone, Paneli Shqyrtues konsideron se ky pretendim është i bazuar.
Po ashtu është i qëndrueshëm pretendimi i OE ankues se i rekomanduari për kontratë nuk ka dorëzuar CV për Zvonimir Todorovski si pjesë e stafit profesional. Andaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se AK-ja duhet të veproj në përputhje me nenin 39 të RrUOPP-se, pikës 11 të tabelës së dhëne në këtë rregullore.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore dhe sqarimeve të ekspertit shqyertues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk e ka bërë ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve në bazë të kritereve të përcaktuara në dosje të tenderit dhe në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së.

Andaj, obligohet AK që të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, si dhe të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve duke u bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesues i Panelit Shqyrtues

Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - Korporata Energjetike e Kosovës sh.a.;

1x1 OE "STUDIO HAPSIRA" SH.P.K. & "TAULANT"SH.P.K & "AVE CONSULTING"SH.P.K– Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.